



РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА
РЕПУБЛИКА Е МАКЕДОНИСЕ СЕ

Бр./Nr _____

_____г./в.



Në bazë të nenit 22 paragrafi 1 të Ligjit për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesit ("Gazeta zyrtare e RM" nr. 12/19), neni 40 paragrafi 2 i Rregullores së punës së Komisionit Shtetëror për Parandalimi i Korrupsionit, duke vepruar në bazë të denoncimit të paraqitur nga një parashtrues i njohur, Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit (në tekstin e mëtejme Komisioni për Parandalimin e Korrupsionit), në seancën e 96-të të mbajtur më 27.11.2023, ka miratuar sa vijon.

VENDIM

Veprimi sipas denoncimit me numër 12-5136/1 të datës 30.10.2023, **NDËRPRITET.**

Denoncimi nuk ka elemente për veprim kompetent.

Lënda me numër 12-5136 të vitit 2023 të mbyllet dhe të arkivohet.

Vendimi i KSHPK-së duhet në formë të depersonalizuar të publikohet në faqen e internetit të Komisionit Shtetëror brenda 5 (pesë) ditëve nga miratimi i tij.

Arsyetim

Lënda me numër 12-5136/1 datë 30.10.2023 është ngritur në bazë të denoncimit të dorëzuar nga ///. Denoncimi përmban pretendime të përgjithshme në lidhje me situatën me zgjedhjet lokale në Komunë /// për vitin ///, pa specifikuar veprime konkrete për abuzime të mundshme nga personat zyrtarë në Komunë ///.

Me qëllim dhënien e informacionit që do të rezultonte me elemente për veprim kompetent nga KSHPK-ja, parashtruesit për rastin në fjalë në mënyrë elektronike i janë kërkuar të dhëna dhe informacione shtesë, duke paraqitur kërkesë në adresën e tij elektronike.

Pas kërkesës drejtuar parashtruesit, për sqarim të mëtejshëm të denoncimit, ai ka dorëzuar sqarime të mëtejshme të kërkesës në mënyrë elektronike, më datë 12.11.2023, në KSHPK, por sërish pa specifikuar veprime konkrete për keqpërdorime të mundshme nga personat zyrtarë në Komunën e ///.

Në këtë gjendje, KSHPK-ja vlerësoi se denoncimi i parashtruesit i referohet pakënaqësisë me mënyrën e organizimit dhe zhvillimit të zgjedhjeve vendore në komunë /// për vitin ///, për ç'arsye vendosi refuzimin e kërkesës dhe lënda të mbyllet dhe të arkivohet.

Sipas sa më sipër KSHPK-ja vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Dorëzuar:
- Parashtruesi

përgatiti: м-р Д. Д.
miratoi: С. П. Д.

KOMISIONI SHTETËROR

Адреса: ул. Пресвета Богородица број 3, 1000 Скопје - Република Северна Македонија

Adresa: rr. Presveta Bogorodica nr.3, 1000 Shkup - Republika e Maqedonisë së Veriut

email: contact@dksk.org.mk

тел/tel: +389 2 3248 930

<https://www.dksk.mk>

ПЁР ПАРАНДАЛИМИН Е КОРРУПСИОНИТ

Kryetar,
Biljana Ivanovska

